



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ**

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

**DREJTUAR TË RINJVE, BANORËVE TË BASHKISË KAMËZ DHE TË GJITHË PALËVE
TË INTERESUARA.**

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit Nr. 146/2014 “ Për njoftimin dhe konsultimin publik” në nenin 9, pika 1, 3 , të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore neni 18, në rregulloren e Këshillit Bashkiak, për konsultimin publik”.

Titulli i projekt-aktit që hapet për konsultim me publikun:

“MIRATIMI I PLANIT VENDOR TË RINISË 2026-2030, PËR BASHKINË KAMËZ”

Ftojme të gjithë grupet e interesit si: të rinj/ të reja, student, banorë të Bashkisë Kamëz, administratorët e njësive dhe lagjeve administrative të Bashkisë Kamëz, ndërlidhës të lagjeve administrative, grupet e marginalizuara, shoqërinë civile, etj., të bëhen pjesë e kësaj dëgjese për një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Konsultimi publik do të zhvillohet sipas kalendarit të mëposhtëm:

Datë: 05/03/ 2026

Ora: 11:30

Vendi: Në ambjentet e shkollës “Angela Merkel”

Ky takim ka si qëllim kryesor bashkëpunimin dhe mbledhjen e rekomandimeve, të cilat do të shërbejnë për hartimin e Planit Vendor të Rinisë.

Mirëpresim rekomandime, propozime dhe sugjerime konkrete, të cilat mund të dërgohen në adresën e mëposhtme të e-mailit:

-konsultim.publik@kamza.gov.al Koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

Pranohen rekomandime deri më datën 05.03.2026.

Kjo dëgjese do të zhvillohet në bashkëpunim me Bashkinë, Njësitë dhe Lagjet Administrative të Bashkisë Kamëz, Anëtarë/përfaqësues të Këshillit Bashkiak Kamëz.

Jeni të lutur të merrni pjesë, pasi pjesëmarrja juaj është shumë e rëndësishme.

